



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

Numri i lëndës: 2025:190078

Datë: 18.02.2026

Numri i dokumentit: 08486873

KPPP.nr. 1004/25

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Florent Zeqiri, në çështjen përmbartimore të kreditorit Korporata Energjetike e Kosovës Sh.A., me seli në Prishtinë, Sheshi “Nëna Terezë” nr. 36, kundër debitorit “Kosovo Electricity Supply Company J.S.C” (KESCO) Sh.A., me numër unik identifikues 811288887 dhe me seli në Prishtinë, Bulevardi Bill Clinton, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Visar Vehapi, avokat nga Prishtina, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr. 502/25 të datës 05.09.2025, të lejuar nga Përmbartuesi Privat Isak Islami me seli në Prishtinë, jashtë seancës, me datën 18.02.2026 merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET në tërësi si i pa bazuar prapësimi i debitorit “Kosovo Electricity Supply Company J.S.C” (KESCO) Sh.A., i ushtruar ndaj Urdhrit Përmbartimor P.nr. 502/25 të datës 05.09.2025, të lejuar nga Përmbartuesi Privat Isak Islami.
- II. Urdhri Përmbartimor P.nr. 502/25 i datës 05.09.2025, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Isak Islami me seli në Prishtinë, MBETET NË FUQI.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Korporata Energjetike e Kosovës Sh.A., me datë 05.09.2025 ka lëshuar urdhrin P.nr. 502/25, duke lejuar përmbartimin në bazë të dokumenteve të besueshme: Faturës nr. 1006654 të datës 05.02.2025; Faturës nr. 1006844 të datës 04.03.2025 dhe Fatura nr. 1007065 të datës 04.04.2025, ashtu që është urdhëruar debitor

“Kosovo Electricity Supply Company J.S.C” (KESCO) Sh.A., që në emër të borxhit të përcaktuar sipas faturave të lartcekura t’ia paguaj kreditorit shumën e përgjithshme prej 40,886.033.58 EUR (*dyzet milionë e tetëqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë e tridhjetë e tre euro e pesëdhjetë e tetë cent*), me kamatë ligjore prej 8% nga data e arritjes për pagesë e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës përbarimore.

Debitori, përmes përfaqësuesit të autorizuar, brenda afatit ligjor ka parashtruar Prapësim duke kundërshtuar në tërësi Urdhrin Përbarimor si të kundërligjshëm duke theksuar se dokumentet e besueshme mbi bazën e të cilave është lejuar përbarimi ndaj debitorit nuk kanë tipare të përbarueshmërisë. Ka deklaruar se komunikimeve përmes adresës elektronike të datës 05.02.2025, dt. 04.03.2025 dhe dr. 04.04.2025 të bëra nga gjoja z. D.G në emër të debitorit iu mungon vlefshmëria pasi që ekziston dyshimi se të njëjtat nuk janë autentike dhe janë të manipuluar, rrethanë kjo që duhet të vërtetohet me ekspertizë të specializuar kompjuterike. Për më tepër, ka shtuar se edhe sikur këto komunikime të ishin autentike, personi dërgues D.G nuk ka pasur asnjë autorizim ligjor për të pranuar ndonjë faturë apo obligim financiar ndaj debitorit meqenëse i njëjti nuk është në pozitë vendimmarrëse dhe as person i autorizuar për pranimin e faturave. Më tej ka shtuar se përmbajtja e këtyre komunikimeve është shtrembëruar nga kreditori pasi që në këto komunikime nuk përmendet askund fjala faturë, numri apo shuma e faturës, apo një deklaram nga ana e KESCO që pranon detyrimin sipas faturave, por vetëm flitet për “të dhëna energjetike dhe financiare” që nënkupton një konfirmim teknik të sasisë së energjisë dhe vlerës së përlllogaritur, por jo pranimin formalo - juridik të faturës si detyrim i pakontestueshëm. Më tej ka shtuar se pavarësisht faktit se faturat përmbajnë edhe vulën e pranimin nga arkiva e KESCO-së, debitori e konteston autenticitetin dhe peshën provuese të këtyre vulave ashtu që vetëm përmes një ekspertize të grafologjisë, do mund të vërtetohet nëse vulat apo shënimet e protokollit në kopjet e faturave janë autentike dhe konform standardeve të debitorit. Për më tepër, ka shtuar se edhe nëse supozohet se kjo vulë e pranimin është autentike, ajo nuk përfaqëson vullnet juridik për pranim të detyrimit nga ana e debitorit por vetëm veprim administrativ të pranimin fizik të një dokumentit. Më tej ka shtuar se faturave iu mungojnë elementet komulative nga neni 29.3 i LPP-së meqenëse të njëjtat nuk janë të nënshkruara dhe nuk është paraqitur deklaratë me shkrim për arritshmërinë e kredisë. Nga të lartcekurat, gjykatës i ka kërkuar që të aprovohet prapësimi i debitorit, të anulohet urdhri përbarimor P.nr. 502/25 i datës 05.09.2025 dhe të përfundohet procedura përbarimore.

Kreditori, në përgjigje ndaj prapësimit ka kundërshtuar në tërësi pretendimet e paraqitura nga debitori duke shtuar se prapësimi i paraqitur, nuk i plotëson asnjë nga shkaqet taksative nga neni 71 i LPP-së mbi bazën e të cilit mund të anulohet urdhri përmbarimor . Ka shtuar se të gjitha pretendimet lidhur me kompetencën apo autoritetin dhe autorizimin e personit Dasar Gashi janë të pa vërteta pasi që personi në fjalë, çdo herë ka pranuar faturat për shpenzim të energjisë elektrike e për të qenë të saktë, të gjithë vartësit e tij deri tek Drejtori Ekzekutiv-Financiar i debitorit kanë qenë të vendosur në korrespondencë në email, ndërsa pranimi i faturave dhe lëshimi i konfirmimeve nuk ka qenë asnjëherë kontestues pasi që po të ishin të tilla, faturat do të kundërshtoheshin që në momentin e pranimit të shkresës zyrtare me nr. të protokollit 2732 të datës 24.05.2025 me të cilën kreditori ka kërkuar përmbushjen e obligimeve nga debitori. Ka shtuar se nuk qëndron pretendimi i debitorit se kredia nuk është bërë e kërkueshme sipas faturave pasi që kreditori e ka dëshmuar me provë përkatësisht me shkresën zyrtare me nr. të protokollit 2732 të datës 24.05.2025 se e ka bërë të kërkueshme kredinë. Andaj i ka propozuar gjykatës që prapësimi i debitorit të refuzohet, ndërsa urdhri përmbarimor të mbetet në fuqi.

Gjykata, pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, pretendimeve të kreditorit të paraqitura në përgjigje në prapësim, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i pabazuar për shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me nën-par.1.3 të këtij neni fatura përcaktohet si një nga dokumentet e besueshme, kurse me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*, dhe me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*.

Gjykata në rastin konkret vlerëson se urdhri përmbarimor P.nr. 502/25 i datës 05.09.2025 i lëshuar nga ana e Përmbaruesit Privat kundrejt debitorit bazohet në faturën nr. 1006654 të datës 05.02.2025, faturën nr. 1006844 të datës 04.03.2025 dhe faturën nr. 1007065 të datës 04.04.2025 të cilat i plotësojnë kushtet për të qenë dokumente të besueshme dhe i përmbajnë të gjitha elementet e kërkuara në përputhje sipas nenit 29, par. 3 të LPP-së, meqenëse në secilën faturë

janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara mallrat të cilat kanë qenë objekt i faturave, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi, dhe faturat i janë bashkangjitur propozimit për përbarim në kopje të vërtetuar nga origjinali, në përputhje me nenin 37 të LPP-së.

Gjykata më tej gjeti se faturat e lartcekura janë pranuar në mënyrë të rregullt nga ana e debitorit, fakt ky që vërtetohet nga vula e pranimin të shkresave e debitorit e evidentuar tek pranuesi i secilës faturë. Ndërsa, fakti që debitori ka qenë në dijeni për detyrimin i cili e vë në obligim të njëjtin sipas faturave të lartcekura gjykata e vërtetoi edhe nga komunikimet përmes adresës elektronike të datave 05.02.2025, dt. 04.03.2025 dhe dt. 04.04.2025 të zhvilluar në mes kreditorit dhe zyrtarit përgjegjës të debitorit – menaxherit për barazime përfundimtare Z. Dasar Gashi.

Nga këto komunikime rezulton se kreditori, fillimisht e ka njoftuar debitorin për sasinë e furnizimit me energji elektrike dhe çmimin e furnizimit, kjo konform marrëveshjes për çmime të arritur në mes kreditorit dhe debitorit të datës 17.10.2012 si dhe rregullave të tregut për energjinë e nominuar mes palëve. Në këto komunikime, është kërkuar nga debitori që të konfirmohet nëse të dhënat sa i përket sasisë së energjisë dhe çmimit të furnizimit janë të sakta, në mënyrë që të procedohet me lëshimin e faturës përkatëse. Ndërsa, në përgjigje të këtyre kërkesave për konfirmime, zyrtari përgjegjës i të paditurës ka konfirmuar se të dhënat energjetike dhe financiare të dërguara në emër të KESCO, për energjinë e marrë nga KEK në bazë të nominimeve për Muajin Janar, Shkurt dhe Mars 2025 janë të sakta.

Për rrjedhojë, gjykata erdhi në përfundim se faturat objekt i këtij përbarimi që i referohen furnizimit të energjisë nga kreditori për debitorin për muajin Janar, Shkurt dhe Mars 2025 janë të përshtatshme për përbarim meqenëse lëshimit të tyre i ka paraprirë dakordimi i plotë mes kreditorit dhe debitorit për të dhënat energjetike, që i referohet sasisë së energjisë së furnizuar nga kreditori për debitorin si dhe të dhënave financiare, që i referohet çmimit të furnizimit të këtij malli si detyrim i debitorit. Ndërsa në fund, dorëzimi i faturave është bërë në mënyrë të rregullt tek debitori ku të njëjtat janë pranuar përmes arkivës së shkresave të debitorit.

Nga këto të gjetura, gjykata erdhi në përfundim se fatura nr. 1006654 e datës 05.02.2025, fatura nr. 1006844 të datës 04.03.2025 dhe fatura nr. 1007065 të datës 04.04.2025 i plotësojnë kushtet për të qenë dokumente të besueshme nga neni 29 par.3 i LPP-së dhe paraqesin bazë për lejimin e përbarimit ndaj debitorit meqenëse të njëjtat kanë tipare të përbarueshmërisë.

Gjykata ka vlerësuar pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim se komunikimet përmes adresës elektronike nga ana e personit D.G nuk janë autentike dhe nuk janë origjinale dhe se personi në fjalë, nuk ka qenë i autorizuar që të pranoj asnjë faturë apo detyrim në emër të debitorit por pretendimet në fjalë gjykata i vlerësoi si të pabazuara. Kjo nisur nga fakti se komunikimet përmes adresës elektronike të datës 05.02.2025, dt. 04.03.2025 dhe dt. 04.04.2025 ku konfirmohet furnizimi i energjisë nga kreditori për debitorin dhe çmimi i furnizimit, janë lëshuar nga D.G në cilësi të menaxherit për barazim përfundimtar pranë debitorit. Ndërsa, fakti se këto komunikime janë autentike dhe janë lëshuar nga personi fizik D.G në funksion të pozitës të cilën e ushtron tek debitori dhe jo në cilësi personale, e vërteton fakti se adresa elektronike e të njëjtit mbanë domenin e debitorit @kesco-energy.com. E në shtesë të saj, në këtë komunikim, në korrespondencë kanë qenë edhe 14 zyrtarë tjerë të debitorit të identifikuar me emër dhe mbiemër, ndërsa në asnjë prej këtyre komunikimeve nuk është paraqitur vërejtje në kuptim të autenticitetit apo autorizimeve për komunikimet e bëra.

Gjykata, po ashtu e gjeti si të paqëndrueshëm pretendimin e debitorit se vula e pranimit të shkresave të debitorit e evidentuar në faturat kontestuese është jo valide kjo pasi që secila faturë, përmban llogon e debitorit, numrin e protokollit të debitorit dhe datën e pranimit të faturës. Ndërsa, pretendimi se evidentimi i kësaj vule në faturat e lëshuara nga kreditori nënkupton vetëm veprim administrativ dhe jo pranim juridik të detyrimeve sipas këtyre faturave gjykata e vlerësoi si të pabazuar meqenëse nga provat e bashkangjitura në shkresat e lëndës, gjykata gjeti se furnizimi i energjisë elektrike, sasia e furnizimit dhe çmimi i furnizimit, elemente këto të pasqyruara në faturat e lëshuara nga kreditori, janë dakorduar dhe konfirmuar paraprakisht nga vet pala debitore.

Ndërsa, kërkesat e debitorit që në këtë procedurë përmbarimore të caktohet ekspertizë nga lëmia kompjuterike për të vërtetuar autenticitetin dhe origjinalitetin e komunikimeve elektronike të zhvilluara në mes debitorit dhe kreditorit, si dhe nxjerrjen e ekspertizës nga lëmia e grafologjisë për të vërtetuar autenticitetin e vulës së pranimit të shkresave gjykata i gjeti në tërësi si të paqëndrueshme. Kjo për faktin se në këtë procedurë të karakterit rigoroz formal, gjykata kufizohet vetëm në vlerësimin e elementeve formale të faturave të cilat janë objekt i këtij përmbarimi dhe përshtatshmërisë së tyre si dokumente të besueshme.

E në këtë drejtim, pavarësisht faktit se debitori ka pretenduar se komunikimet elektronike janë jo autentike dhe vula e pranimit të shkresave të debitorit është manipuluar dhe nuk është

originale, i njëjti nuk ka bashkangjitur asnjë provë të vetme se në raport me këto rrethana që ngrehin pas vete përgjegjësi penale, debitori ka iniciuar kallëzim penal pranë autoriteteve kompetente për keqpërdorimet e pretenduara nga personat që janë të identifikuar me emër dhe mbiemër për debitorin, prova këto të cilat debitori obligohet që t'i parashtrij konform nenit 69 par.4 të LPP-së për të mbështetur pretendimet e veta si në prapësim.

Nga këto të gjetura, gjykata erdhi në përfundim se debitori nuk ka ofruar prova të mjaftueshme siç përcaktohet me nenin 69 par.4 të LPP-së për të provuar ekzistimin e shkaqeve taksative të përcaktuara me nenin 71 të LPP-së mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbarimit.

Në këtë drejtim, meqenëse prapësimi i debitorit ka rezultuar qartazi si i pa themeltë, gjykata, nuk e ka parë të arsyeshme që të caktoj seancë dëgjimore sipas nenit 73 par.1 të LPP-së meqenëse caktimi i një seance të tillë, paraqet rast përjashtimor në procedurën përmbarimore dhe vie në shprehje vetëm kur gjykata e vlerëson se për shqyrtimin e validitetit të prapësimit të palës debitore, është e nevojshme caktimi i një seance të tillë, çka nuk ka rezultuar të jetë në rastin konkret.

Nga të lartcekurat, duke u bazuar në nenin 73 par të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 1004/25, datë 18.02.2026

Gjyqtari
Florent Zeqiri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë të Gjykatës Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.